

**PROTOKOLL**  
**NDËRMJET**  
**MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DHE**  
**MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**PËR**  
**IMPLEMENTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT KUFITAR NË PIKËN E**  
**PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR MORINË/KUKËS**

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë (në vijim të referuar si “Palët”),  
Në zbatim të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Shqipërisë së dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit kufitar”, nënshkruar më datë 29 dhjetor 2018, (në vijim referuar si “Marrëveshje”),  
Bien dakord:

**Neni 1**  
**Qëllimi i Protokollit**

Protokolli zbatohet për të gjitha procedurat e përbashkëta të kontrollit kufitar në PPKK Morinë/Kukës, me qëllim lehtësimin e procedurave të kontrollit kufitar sipas parimit një ndalesë - një kontroll.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

Sipas këtij Protokollit termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

1. **“Kontroll kufitar”** – veprimtaria që kryhet në PPKK Morinë/Kukës, si përgjigje posaçërisht ndaj një synimi për të kaluar ose aktit të kalimit të kufirit, pavarësisht nga rrethanat dhe që përbëhet nga verifikimi kufitar e mbikëqyrja kufitare.
2. **“Vendi i hyrjes”** – Pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në hyrje.
3. **“Vendi i daljes”** - Pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në dalje.
4. **“Pikë e përbashkët e kalimit kufitar”** - është pika e përbashkët e kalimit kufitar Morinë/Kukës, e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në të cilin nëpunësit kufitarë të Palëve kryejnë verifikime kufitare në hyrje dhe në dalje, njëri pas tjetrit, në përputhje me legjislacionin respektiv shtetëror dhe sipas Marrëveshjes dypalëshe.
5. **“Zona e pikës së përbashkët të kalimit kufitar”** - (më tutje: ZPPKK), është hapësira e shënuar në formë rrethore përreth pikës së përbashkët të kalimit kufitar me diametër 1 km, ku nëpunësit e të dy Palëve janë të autorizuar të kryejnë verifikimin kufitar, sipas kompetencave.

6. **“Zona e kontrollit kufitar”** – është zona e përcaktuar dhe e shënuar nga Palët, në të cilën mund të kryhen verifikime kufitare sipas legjislacionit shtetëror të Palëve.

7. **“Verifikim kufitar”** - është veprimtaria që kryhet në pikën e përbashkët të kalimit të kufirit për të garantuar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të lejohen për të hyrë ose për të dalë në territorin e Palëve.

8. **“Nëpunës”** - punonjës i Policisë Kufitare, Shërbimit Doganor dhe shërbimeve të tjera kufitare të autorizuara nga Palët

9. **“Mallrat”** – mallrat, mjetet e transportit dhe vlerat materiale, të cilat i nënshtrohen rregullave doganore;

10. **“Parimi- një ndalesë - një kontroll”** - verifikimi kufitar i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje, në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat.

11. **“Komisioni i përbashkët i ekspertëve”** - (më tutje: KPE) është krijuar në zbatim të nenit të Marrëveshjes dhe është kompetent për zbatimin e këtij Protokoll

12. **“Administrator”** - pala shqiptare, e cila në bazë të Marrëveshjes është përgjegjëse për mirëmbajtjen e PPKK Morinë/Kukës.

### Neni 3

#### Vendndodhja e PPKK-së dhe procedurat në ZPPKK

1. Për veprimtaritë e përbashkëta, sipas këtij Protokoll, vendndodhja e PPKK është caktuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku nëpunësit shqiptarë dhe ata kosovarë bashkërisht kryejnë kontrollet kufitare.

2. Palët nënshkruese, sipas Protokollit përcaktojnë:

a. Procedurat e kthimit në vendin e origjinës ose në vendin tjetër në përputhje me Marrëveshjen për ripranim të një personi të ndaluar, personit nën arrest ose personit të cilit i është refuzuar hyrja, si dhe procedurat e transferimit të mallrave të sekuestruara në procesin e kryerjes së kontrolleve kufitare.

3. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin kufitar nga të dyja palët do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore në përputhje me rregulloret shtetërore.

4. Tekstet në shenjat e objekteve zyrtare duhet të jenë në gjuhët zyrtare të palëve Kontraktuese, ku në varësi të zotërimit të ambientit, teksti në gjuhën zyrtare të vendit të respektuar do të jetë në vendin e parë të përdorur nga punonjësit e vendit fqinj.

### Neni 4

#### Shkëmbimi i informacionit

Nëpunësit e Palëve gjatë marrjes së masave dhe kryerjes së kontrollit siç përcaktohet në këtë Protokoll, do të shkëmbejnë informacion dhe do të ofrojnë asistencë të ndërsjellë.

## **Neni 5** **Zbatimi i akteve ligjore**

1. Të gjitha aktet ligjore të Palëve lidhur me kontrollet kufitare do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës Palë Kontraktuese.
2. Veprimtaritë ditore të cilat nëpunësit e Republikës së Kosovës i kryejnë në ZPPKK, do të konsiderohen si të kryera në territorin e Republikës së Kosovës.
3. Zonë kufitare e Palës, konsiderohet hapësira nga momenti i realizimit të procedurave dalëse të Palës tjetër.

## **Neni 6** **Masat e ndërmarra gjatë kontrollit kufitar**

1. Nëpunësit e secilës Palë kanë të drejtën të ndalojnë, arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e një personi gjatë kontrollit kufitar, por vetëm në përputhje me legjislacionin respektiv kombëtar të Palëve.
2. Kur nëpunësit e Palës ndërmarrin masa, sipas paragrafit 1 të këtij Neni, menjëherë për këtë veprim do të informohen nëpunësit e Palës tjetër.
3. Në rast se kontrolli kufitar kryhet i ndarë, nëpunësit e Palëve mund të ndalojnë, arrestojnë personat ose sekuestrojnë mallrat, bazuar në legjislacionin kombëtar të Palëve.

## **Neni 7** **Kontrolli kufitar i detyrueshëm**

1. Në ZPPKK kontrolli kufitar është i detyrueshëm. Nëse kontrollet kryhen të ndara, përparësi ka kontrolli në hyrje.
2. Personat, automjetet dhe mallrat i nënshtrohen kontrollit të përbashkët kufitar vetëm një herë. Nëse pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në hyrje ka dyshime për vepra penale ose konstatohet se një person, i cili duhet arrestuar është në ZPPKK, nëpunësit e shtetit të daljes janë të autorizuar që të përsërisin procedurat e verifikimit kufitar, pasi të kenë njoftuar paraprakisht nëpunësit e shtetit të hyrjes.
3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët mund të bien dakord që të ndërpritet parimi një ndalesë-një kontroll dhe të rivendosen kontrollet e veçanta.

## **Neni 8** **Lehtësimi i procedurave të kalimit kufitar**

1. Nisur nga situata e veçantë gjatë sezonit turistik veror, që sjell ngarkesë në qarkullim në pikën e përbashkët të kalimit kufitar dhe kur të gjitha burimet që lidhen me personelin, pajisjet, ambientet dhe organizimin janë shteruar, të aplikohet lehtësimi i procedurave të kalimit/verifikimit kufitar për periudhën 1 qershor - 30 shtator.

2. Lehtësimi i procedurave të kalimit/verifikimit kufitar sipas pikës 1 të nenit 8, të aplikohet edhe në rastet e festave zyrtare/shtetërore të Palëve dhe gjate ditëve të fundjavave.

3. Në rastet kur kalimet/verifikimet kufitare janë të lehtësuara, policitë kufitare të Palëve, mund të mos kryejnë regjistrimin, por vetëm verifikimin e shpejtë të vlefshmërisë së dokumentit dhe të identitetit të mbajtësit.

4. Lehtësimi i procedurave të kalimit kufitar referuar pikës 1 të nenit 8, aplikohet vetëm për shtetasit e të dy Palëve.

5. Kur procedurat e kalimit kufitar janë të lehtësuara, kontrollet kufitare në hyrje, si parim, fitojnë përparësi ndaj kontrolleve kufitare në dalje.

6. Lehtësimi i procedurave të kalimit kufitar sipas pikës 1, të nenit 8, mund të jetë edhe i përkohshëm, në përputhje me rrethanat justifikuese të tij dhe zbatohet gradualisht.

7. Në pikën e përbashkët të kalimit kufitar, Palët duhet të mbajnë regjistrat për arsyet, kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit të lehtësimit të procedurave të kalimit kufitar.

8. Gjatë aplikimit të lehtësimit të procedurave të kalimit kufitar, nga Shefat respektiv të Palëve apo ata që i zëvendësojnë, të organizohet kontrolli mbi bazën e situatës dhe përfundimeve të nxjerra nga analiza e riskut për aktivitetin e lëvizjes së shtetasve, që hyjnë dhe dalin nëpërmjet Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Morinë. Ata përgatitin indikatorët dhe profilet e riskut dhe mbi këtë bazë menaxhojnë burimet që kanë në dispozicion për të kryer detyrën.

### **Neni 9 Refuzimi i hyrjes**

Personave, shtetas të Republikës së Shqipërisë ose Republikës së Kosovës, të cilëve nga nëpunësit e vendit të hyrjes u është refuzuar hyrja, nuk do t'u mohohet e drejta e kthimit në vendin e origjinës. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në vendin e daljes.

### **Neni 10 Sekuestrimi i mallrave, mjeteve, letrave me vlerë dhe të hollave**

1. Në rastet e parimit - një ndalesë - një kontroll, mallrat, mjetet, letrat me vlerë dhe të hollat do të sekuestrohen nga pala konstatuese dhe do të trajtohen sipa legjislacionit të kësaj Pale.

2. Mallrat, mjetet, letrat me vlerë dhe të hollat e sekuestruara përkohësisht nga nëpunësit e Palëve nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit gjatë kthimit të tyre.

### **Neni 11 Dokumentit i identifikimit dhe uniforma**

1. Nëpunësit e të dy Palëve duhet të kenë dokumentin e identifikimit, i cili u jep të drejtën e hyrjes, qëndrimit dhe të punës në ZPPKK, si dhe kthimit në vendin fqinj.

2. Autoritetet e Palëve, mund të miratojnë dhe lëshojnë leje hyrëse për punonjësit që kryejnë shërbime të përkohshme në PPKK.

3. Nëpunësit e të dy palëve do të mbajnë uniforma gjatë kohës që ata kryejnë veprimtarinë në ZPPKK. Në raste të veçanta, me pëlqimin e autoriteteve kompetente nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me shenjën përkatëse, POLICIA, DOGANA, të dukshme në anën e parme dhe atë të pasme, duke mbajtur dallueshëm kartën identifikuese zyrtare.

#### **Neni 12**

##### **Armët e shërbimit, pajisjet dhe përdorimi i forcës**

1. Nëpunësit e policisë kufitare në PPKK, do të mbajnë armë të shkurtër shërbimi (armë brezi), pajisje policore personale dhe gaz lotsjellës, referuar parashikimeve të rregullave dhe legjislacionit shtetëror të Palëve.
2. Palët gjatë procedurës së kontrollit të detajuar kufitar mund t'i përdorin qentë e shërbimit, në përputhje me procedurat e kontrollit.
3. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, si dhe mjetet shtrënguese, , duke përfshirë armët e zjarrit, mund të përdoren në përputhje me legjislacionin respekti të Palëve. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit duhet të jetë në proporcion me nivelin e kërcënimit dhe seriozitetin e kriminit që parandalohet ose shtypet, në mënyrë të përmbajtur, duke përdorur një forcë të nevojshme proporcionale, në mënyrë që detyra zyrtare të mund të kryhet pa pasoja negative.

#### **Neni 13**

##### **Pajisjet zyrtare**

1. Palët mund t'i instalojnë dhe përdorin nga nëpunësit e tyre respektivë pajisjet teknike të domosdoshme për kryerjen e veprimtarive lidhur me kontrollin kufitar në ZPPKK.
2. Pala shqiptare do t'i lejojë palës kosovare instalimin, ndërrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të telekomunikimit, posaçërisht për nevojat e kontrollit kufitar në ZPPKK.
3. Shfrytëzimi i këtyre pajisjeve konsideron qarkullimin e brendshëm në territorin e Palës.

#### **Neni 14**

##### **Të drejtat dhe detyrimet**

Nëpunësit respektivë të Palëve gjatë detyrave të tyre në ZPPKK, kanë të drejta dhe detyrime të barabarta.

#### **Neni 15**

##### **Shfrytëzimi i mjeteve për nevoja zyrtare**

1. Mjetet dhe pajisjet e Palëve të caktuara për nevoja zyrtare në ZPPKK do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore, kufizime ose taksa të tjera. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.
2. Dokumentet, pajisjet teknike dhe informative që përmbajnë të dhëna e të cilat i përdorin nëpunësit për kryerjen e detyrave të tyre në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet e tjera nuk do të kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e palës tjetër.

**Neni 16**  
**Shpenzimet financiare dhe mirëmbajtja në PPKK**

Shpenzimet financiare dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta në PPKK, do të bëhen sipas parashikimeve të Protokollit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, firmosur në Pejë, Kosovë, me datë 26.11.2018.

**Neni 17**  
**Shtesat dhe ndryshimet e Protokollit**

Palët mund të bien dakord të bëjnë ndryshime dhe shtesa në këtë protokoll. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 19, të këtij protokoll.

**Neni 18**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Protokoll do të zgjidhet nga Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve (KPE).
2. Nëse KPE nuk do të jetë në gjendje të gjejë një zgjidhje të pranuar nga të dy palët brenda tre muajve, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me bisedime dypalëshe nëpërmjet kanaleve diplomatike.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të zbatohet pas vendosjes së kontrolleve kufitare të Palëve në këtë PPKK dhe me anë të njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Ky Protokoll lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.  
Palët mund ta pezullojnë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e këtij Protokoll për shkak të rendit publik ose shëndetit publik, gjë për të cilën duhet të informojnë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Ky Protokoll nënshkruhet më 20.06.2022 në Prishtinë, në dy origjinale secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike dhe njëloj të barasvlershme.

Në rast mosmarrëveshje në interpretimin e këtij Protokoll, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**Për Ministrinë e Punëve të Brendshme  
të Republikës së Kosovës**

**Ministri**  
**Xhelal SVEÇLA**

**Për Ministrinë e Brendshme  
të Republikës së Shqipërisë**

**Ministri**  
**Bledar ÇUÇI**